



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Sesioni pranveror

Komisioni për Integritet Evropian

Mbledhja nr. 15.

Prishtinë, më 21.04.2015, në ora 11:00.

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-303.

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRITET EVROPIAN

Në mbledhje morën pjesë: Teuta Sahatqija, Valdete Bajrami, Time Kadriaj, Rustem Mustafa, Arben Gashi, Luljeta Veselaj- Gutaj, Ilir Deda dhe Kujtim Paçaku.

Munguan: Xhavit Haliti; Vjosa Osmani, dhe Slllobodan Petroviq.

Nga stafi mbështetës i Komisionit: Ahter Loxha, Adelina Demolli, Safet Beqiri, dhe Florent Mehmeti.

Mbledhjen e kryesoi znj. Teuta Sahatqija – kryetare e Komisionit.

Rendi i Ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.03.2015;**
- 3. Raportim i znj. Hykmete Bajrami – Ministre e Tregtisë dhe Industrisë;**
- 4. Të ndryshme.**

Pasi kryetarja e komisionit znj. Teuta Sahatqija ishte vonuar për 10 minuta, znj. Valdete Bajrami, nënkryetare e parë e Komisionit pasi konstatoi se janë plotësuar kushtet për punë e hapi mbledhjen

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24.03.2015

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Raportim i znj. Hykmete Bajrami – Ministre e Tregtisë dhe Industrisë

Në mbledhje mori pjesë z. Avni Kastrati, zv. ministër i Tregtisë dhe Industrisë pasi që ministria znj. Hykmete Bajrami nuk kishte mundur të merte pjesë.

Zv. ministri Avni Kastrati- E përshëndeti Komisionin në emër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe beson që bashkëpunimi me Komisionin do të jetë në nivelin e duhur dhe bashkërisht t'i përmbushin obligimet që dalin nga MSA, sepse Ministria e Tregtisë dhe Industrisë është njëra prej ministrive që ka më së shumti obligime të dalura nga MSA. Materialin që e keni marrë me vonesë është shumë specifik dhe në vazhdim do të kalojë në material dhe pastaj priten pyetjet nga deputetët.

Ilir Deda kërkoj nga zv. ministri që mos ta prezantojë tani raportin, sepse ka të bëjë me raportin e progresit, por të tregojë se cilat i shohin si sfida për MSA-në, sepse tha se këtu nuk është përmend MSA prej së cilës merrni obligime shtesë.

Avni Kastrati –Tha se në këtë material e kemi përgatitur në bazë të kapitujve që kanë qenë dhe e kemi filluar nga kapitulli 3.1, 3.3, 3.7.2, 4.1.10 dhe 5.2.

Në kapitullin 3.1 kanë qenë sfidat për hyrje dhe dalje në treg dhe tani veprimet e ndërmarra janë kapacitete më të forta administrative dhe qasja më e mirë në financa.

Sa i përket kapitullit 3.3.-Lëvizja e lirë e mallrave, lidhur me këtë kemi bërë aktivitete në ngritjen e vetëdijes së bizneseve në përdorimin e standardeve.

Në Metrologji është bërë avancim në funksionalizimin e mëtejme të laboratorëve. Pastaj akreditimin si një agjenci, i cila me aktivitetet e veta akrediton subjektet që duhet të merren me një fushë.

Nga inspektorati dhe konsumatori kemi tentuar që të bëjmë përmirësimin e komunikimit dhe koordinimit mes institucioneve relevante dhe njëkohësisht themelimin e trupës e cila kish me i koordinua këto aktivitete.

Në kapitullin 3.4.2 është e drejta e themelimit dhe liria e ofrimit të shërbimeve.

Jemi duke punuar në adaptimin e ligjit për shërbime që kap rrafshin horizontal dhe vazhdimin e identifikimit të zbrastirave ligjore në lëvizjen e shërbimeve.

Në pikën 3.5.2 kemi sfida në fushën e të drejtave të pronësisë industriale, për këtë kemi organizua trajnime të stafit dhe takime të shpeshta me Këshillin kombëtar.

Sa i përket kapitullit 4.1, ne, si Kosovë, nuk jemi anëtare e Organizatës botërore e tregtisë dhe në këtë drejtim kemi filluar aktivitete për lobimin që fillimisht të jemi vëzhgues e mandej edhe anëtare e kësaj organizate.

Në pikën 3.7.2 e kemi Promovimi dhe mbrojtja e investimeve, bashkëpunimi industrial, NVM-të dhe turizmi.

Këtu jemi duke punuar për të arritur regjistrimin online të bizneseve, kemi implementimin e aktit të biznesit të vogël që kërkohet të jetë prioritet për të ardhmen. Pastaj monitorimi i përafërt i implementimit të Strategjisë për zhvillimin e sektorit privat 2013-2017 dhe planit të veprimit.

Progresi i limituar në politikën industriale dhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme neve na shtynë që këtu të japim një përparësi të veçantë në periudhën e ardhshme, që ky progres të jetë më dinamik, e jo si deri më tani.

Pika e fundit në raportet që janë bërë thuhet se nuk ka pasur plan kombëtar për zonat ekonomike, gjë që nuk është e vërtetë, sepse koncepti i planit është miratuar në Qeveri disa muaj më parë.

Në fund të diskutimit tha se pasi që raporti ka ardhur me vonesë, ne jemi të gatshëm të organizojmë edhe një takim dhe të bisedojmë në mënyrë më të detajzuar.

Kryetarja e Komisionit znj. Teuta Sahatqija së pari kërkoj falje nga zv. ministri për vonesën sepse kishte pasur edhe një konferencë tjetër.

Kërkoj që herave tjera të dërgohet me kohë raporti me shkrim i detajuar së paku 4 ditë para mbajtjes së mbledhjes në mënyrë që deputet të përgatiten me kohë.

Sa i përket integritimeve filloi me disa pyetje.

Raporti i Progresit e analizon gjendjen në mënyrë kontinue, e analizon gjendjen në fusha të ndryshme në raport me integritet evropiane.

Në vazhdim tha se kishte pyetje për metrologji, njësia e metrologjisë funksionon në Prizren dhe funksionon te metalet, por paska një ndryshim me spektrometrin e ri dhe ka përparime.

Kërkoj që të sqaroj lidhur me njehsorët digjital të cilat po përfolën edhe në media dhe kemi pasur kërkesa edhe në mandatin e kaluar për tërheqjen e tyre, kemi pa se një pjesë e tyre është tërheq, akreditimi i tyre kthimi në punë, pra lidhur me këtë kërkoj sqarim.

Ajo tha se në raport pashë se keni vazhduar të keni takime me CEFTEN, por e di që keni pasur probleme në raport me shtetet e tjera, më intereson a janë eliminuar ato probleme.

A është Kosova anëtare e barabartë dhe a ka probleme me tregti me shtetet e tjera, të cilat kanë ekzistua përpara si pengesë dhe pengesë të cilën e hasim edhe në organizime të tjera, jo vetëm tregtare, sidomos nga ana e Serbisë dhe Bosnjës dhe a janë eliminuar këto pengesa me CEFTEN? Përveç organizatës botërore që jeni duke u pregaditur me cilat organizata të tjera, si ministri jeni paraparë të regjistroni dhe me cilat pengesa po ballafaqoheni?

Sa i përket sektorit privat është ende i pa zhvilluar, por është pozitive që ne programin e ri qeverisës sektori privat po shëndërohet në prioritet dhe veprimet afirmative kanë filluar të marini hapat e parë. Në raport i pashë disa skema garantuese për kredi dhe grande, por nëse mendoni se duhet të flasim më tepër për këto çfarë janë ndryshimet.

Mospërputhja mes kodit doganor, akcizave dhe kodit penal janë çështje të cilat mbasin për t'u adresuar, andaj na tregoni a ka ndonjë veprim për tu vënë në harmonizim këto.

Deri ku ka arit fiskalizimi i bizneseve dhe cilat janë pengesat në të cilat ju ballafaqoheni .

Çështja tjetër është se në regjistrin e bizneseve janë 90 mijë deri në 100 mijë biznese të regjistruara, por në ATK shohim se nuk janë më tepër se 40 mijë që paguajnë tatimin. Nuk besoj që janë më tepër se 50 mijë biznese janë pjesa jo formale dhe mendoj se pjesa më madhe e tyre janë të shuara dhe do të duhej të shihet pse etj.

Kemi pasur ankesa se procedurat për mbyllje të bizneseve janë shumë të vështirësuar dhe a keni ndërmend të ndërmerrni diçka, sepse ky raport i pa favorshëm mund ta sjellë Kosovën në raportet ndërkombëtare në pozitë të keqe, sepse mund të tregojë se pjesa joformale fshihet pas kësaj.

Në fund pyeti se a ka edhe tani skema te garantimit të kredive speciale për gratë në biznes, sepse në mandatin e kaluar ka pasur.

Valdete Bajrami - Pyeti se si ka qenë gjendja të cilën e keni gjetur në ministri dhe si jeni duke ndërtua politika për ndërrmarjet e vogla të mesme.

Zv. ministri - Tha se metrologjia është një institucion shumë rëndësishëm, ka shumë avancime, por shumë duhet me u punuar, sepse objekti në të cilin e zhvillon aktivitetin metrologjia nuk mund t'i kryejë obligimet e saj ligjore. Ne kemi marrë përsipër të sigurojmë laboratorët, i kemi kontraktuar dy ekspertë nga Sllovenia të cilët duhet të na tregojnë çka duhet më tutje me u punua në metrologji sipas prioritetëve.

Këtë vit nga IPA fondet kemi planifiku nja 150 mi € për kompletimin e pajisjeve në metrologji.

Sa i përket njehsorëve elektronik, lënda është në prokurori për tu vërtetuar cili është realiteti, por për deri sa nuk del raporti nga prokuroria nuk e shohim të udhës të komentojmë rreth këtij problemi.

Sa i përket raportit me CEFTEN dhe pengesat që i hasim për organizime të tjera nuk isha ndalur me Serbin, sepse i dimë problemet, por në fund të vitit të kaluar ka qenë problemi me Bosnjën sepse nuk na i ka njohur dokumentet tona, për eksport të produkteve ushqimore dhe jo ushqimore.

Në muajin dhjetor të vitit të kaluar është mbajtur një takim në Slloveni në mbështetje të BE-së, dhe ai problem është tejkalua dhe Bosnja pas dy muajve i ka pranuar dokumentet tona/.

Sa i përket anëtarësimit në organizata të tjera nuk dha përgjigje, sepse tha se në ministri është vetëm për një muaj. Në vazhdim tha se sektori privat do të ketë prioritet në të gjitha politikat e

Ministrisë së Tregtisë, por fatkeqësisht nuk po munden me ndihmua aq sa duhet sepse jemi në një situatë tranzitore, nga se për këtë mandat qeverisë prioritet është zhvillimi ekonomik dhe përkrahja e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, dhe jemi duke u munduar në atë drejtim, por nuk jam i kënaqur sepse biznesin privat po e shohim si një biznes që duhet me qenë i varur prej nesh, e jo e kundërta. Duhet së pari me e ndërrua mentalitetin jo vetëm në këtë ministri por në tersi në institucione.

Sa i përket ekonomisë jo formale çdo ditë e më tepër po zvogëlohet, por akoma ekziston dhe me zbatimin e vendimit për qasje në arka fiskale do të jemi në pozicion më të mirë.

Sa i përket qasjes në financa jemi duke punuar që bizneseve të ju ofrojmë shërbimet voucher ku kompanitë e ndryshme posaçërisht të voglat, kanë probleme p.sh. në marketing, kontabilitet dhe tjera mund të kërkojnë prej ekspertëve të cilët janë të certifikuar që ata t'i marrin dhe të merën me problemin e tyre dhe afati është dy muaj që të merën me kompani dhe kompania ta japë raportin se a janë të kënaqur dhe pastaj Ministria e Tregtisë dhe Industrisë iu bën pagesën, duhet me pasur evidentim dhe nuk mundet dikush me e marrë nëse nuk e ka krye punën. Kjo është mundësi e mirë sepse bizneset e reja kanë ndihmesë.

Sa i përket mbylljes së bizneseve, edhe në mandatin e kaluar kur kam ardhur e kam parë një mangësi se për çregjistrimin SHPK-ve në ligj nuk figuron SHPK-ja, por figuron korporata dhe kur shkon me çregjistrua biznesin atij i kërkojnë dokumentet për korporatë të cilat ai nuk mund të i kompletojë dhe ashtu mbesin problemet.

Neve na mbetet me e korrigjuar, sepse qysh është kështu nuk është në rregull, se numri i shoqatave me aftësi të kufizuar (SHPK) është i madh dhe duhet me ju mundësuar regjistrimin e shpejtë, por edhe çregjistrimin kur plotësohen konditat juridike për të cilat ai nuk do të merret me atë biznes.

Kurse sa i përket pyetjes se a ka skema të garantimit të kredive speciale për gratë në biznes, ne e kemi me prioritet dhe në atë drejtim do të punohet shumë, kurse në pyetjen se në çfarë gjendje e kemi gjet ministrinë nuk mund të them asgjë, sepse çdo fillim është i vështirë dhe nuk kisha mundur të jap ndonjë parametër se është më mirë apo më keq.

Ilir Deda - Fillimisht kishte vërejte për ndërrimin e agjendave që po ndodhin, për dy javë rresht, kjo është e pa pranueshme sepse na është konfirmuar se vjen ministrja javën e kaluar dhe raporti na ka ardhur vetëm 30 minuta para mbledhjes.

Raporti është i pa kuptueshëm dhe shumë sipërfaqësor, sepse MSA-ja dhe realizimi i kërkesave të raportit të progresit kushtojnë dhe nga ky raport nuk e dimë sa është kostoja për realizimin e sfidave dhe qëllimeve dhe sa njerëz duhen me u punësuar për me u arritur qëllimet e nevojshme, cilat janë sfidat e tjera reale, sepse këtu nuk ka përmbledhje të sfidave serioze dhe nuk e di sa ju pengojnë mosfunktionalizimi i gjykatave, krimi i organizuar, monopolet tregtare, lobi i importit. etj. Ne duhet ta diskutojmë haptas këtë çështje dhe të dimë se si mund të ju ndihmojmë juve, cili është përkushtimi i partnerëve ndërkombëtarë që të ndihmojnë politiken e tregtisë dhe industrisë së Kosovës. Ne duhet të diskutojmë haptazi që ky Komision në mënyrë unanime të ju ndihmojë sepse është në interesin tonë që të mbërrijmë të gjithë, sepse këtu nuk ka pozitë dhe opozitë të gjithë jemi një.

Në vazhdim tha se e kam të pa qartë me hyrjen në fuqi të MSA, cili është statistikisht benefiti i Kosovës, a do të ketë rritje të eksporteve prej neve a jo? Ne, a jemi ne të gatshëm dhe a kemi infrastrukturën me standarde, të cilat kërkojnë që të ketë rritje të eksporteve. Neve na duhen më tepër statistika që ta kemi të qartë se kah po shkojmë. Këtë po e them si bashkëbisedim për herën e ardhshme që të mund të fokusohemi në probleme dhe aty ku kemi sukses dhe si me u rritur suksesi dhe si me u luftuar problemet. Në fund tha se më mirë kishte qenë ta kishim shty takimin për një javë dhe me e marrë skanimin serioz substancial të sfidave dhe pengesave të cilat ekzistojnë, se sa për të thënë vetëm se e kemi mbajtur këtë mbledhje.

Arben Gashi - Tha se e kam problem në thelb me mënyrën këtu të bashkëbisedimit, me gjithë respektin për zv. Ministrin, por mendoj se jemi duke u bashkëbisedim me raportimin i cili po bëhet sepse këtu nuk po flitet asgjë për dy temat kryesore, për Stabilizim asociimin dhe Raportin

e progresit, çka konkretisht mundet Kuvendi me ju ndihmu juve, cilat janë ligjet që ju kan dalë, këtu po flitet në përgjithësi dhe struktura e raportit nuk është e mirë. E di që ju i keni të ndara kapitujt mënyrat e negocimit dhe diskutimit që i bëni me institucionet e BE-së, por një raport i cili i dërgohet Kuvendit nuk fillon me numrin tre, çka do të thotë kjo, ose e keni bërë copy paste prej dokumentit. Kjo çka po thuhet këtu nuk është serioze dhe mënyra e raportimit, do të kishte qenë më mirë që mbledhja me u mbajtur një herë tjetër me u pregadit më mirë, sepse nuk e kemi asgjë për nguti, ta bëjmë serioze këtë punë, e jo sa për ta plotësuar një radhë. Kuvendi duhet me ditur saktë se çka ka nevojë me ju ndihmuar, cilat ligje duhet me u ndryshuar dhe cilat marrëveshje duhet me u ratifikua, me gjithë respektin për ju dhe delegacionin, por kjo mënyrë e raportimit nuk është e duhura për me e mbërri qëllimin kryesor.

Time Kadrijaj - U pajtua me parafolësit që thanë paraprakisht që nuk po e vlerësojmë shumë cilësinë e këtij takimi, sepse është e pa pranueshme që ministrja në momentin e fundit ta anulojë takimin dhe të ju dërgojë juve që e keni marrë detyrën e zv. ministrit vetëm që një muaj.

Rruga drejt integritit kërkon reforma thelbësore dhe një prej tyre është luftimi i korupcionit dhe e cekët edhe ju se kjo ministri ka më së shumti obligime nga raporti i progresit dhe MSA dhe të gjitha këto kërkojnë të implementohen.

Ministrja në mandatin e kaluar ka qenë deputete dhe ka qenë shumë e zëshme duke kundërshtuar politikat e Qeverisë dhe në momentin që e ka marrë detyrën. Ne kemi shpresuar shumë, por tani ministrja e ka ulur pak tonin dhe nuk po e merr punën seriozisht siç e ka pasur gjatë mandatit si deputete. Industria e naftës është një dikaster shumë i rëndësishëm dhe në Kosovë po ballafaqohet me probleme të shumta dhe çmimi i naftës në Kosovë është më i larti në rajon dhe me gjerë. Ne nuk e dimë se çfarë është cilësia gjë që na bënë me dyshuar se njëkohësisht po dëmtohet shëndeti i qytetarëve me ndotjen e ambientit dhe si pasojë kemi rritjen e numrit të sëmurëve me sëmundje kanceroze.

Në vazhdim pyeti se te regjistrimi i bizneseve po del një diskrepanc mes numrit te bizneseve të regjistruara, sa janë aktive dhe sa jo, e di se secili biznes duhet të regjistrohet në ministrin tuaj dhe tha se po lidhna me shëndetësi dhe pas regjistrimit në ministrin tuaj, bizneset shëndetësore e kanë obligative të licencohen në ministrin e shëndetësisë dhe ne, si deputetë, hasim në këtë diskrepanc, dhe kur i pyesim zyrtarët e lartë thonë se nuk është aktiv. Deri kur mundet me qenë një biznes i cili regjistrohet te ju aktiv dhe kur i kalon ai afat i aktivitetit dhe të kalon në biznes pasiv, a duhet vetë pronari me ardhur me e çaktivizuar atë biznes apo vetë ministria ka një kriter të tillë. Kurse sa i përket ekonomisë jo formale, a do të këtë ndonjë angazhim maksimal në luftimin e kësaj dukurie, sepse me të vërtetë po dëmtojnë bizneset që paguajnë tatime dhe bizneset që janë në shërbim të qytetarëve dhe paguajnë të gjitha obligimet që i kërkon shteti, kurse ato jo formale nuk paguajnë doganë dhe tatime dhe dëmtojnë ata që respektojnë ligjet dhe rregulloret që janë ne fuqi.

Kujtim Paqaku - Tha se i takon komunitetit rom, por kjo gjuhë e cila figuron në raport nuk i ngjan gjuhës shqipe, sepse një rresht me 80 germa nuk kam hasur në asnjë gjuhë dhe këtë raport e konsideroj joserioz dhe përkrah propozimet e parafolësve që të takohemi herën tjetër dhe tha se është i interesuar të di më tepër për mbrojtjen e ekonomisë së vogël në Prizren, Mitrovicë dhe Gjakovë, sepse zejet e vogla po shuhën dita-ditës dhe a ka ndonjë grand për komunitetin rom dhe si do të mbrohet ekonomia e tyre dhe si i njoftoni ata të ekonomisë së vogël.

Rrustem Mustafa – E vlerësoi se në takimin e ardhshëm duhet të fokusohen më tepër në përmirësimin e procedurave burokratike për regjistrimin dhe shuarjen e bizneseve, sepse është e papranueshme që prej 90 mijë bizneseve të regjistruar vetëm 40% të jenë funksionale. Duhet të përmirësohen politikat e ministrisë. Ne, si Kuvend, ku ka nevojë do të ju ndihmojmë dhe do të jemi krah ku ka nevojë për ndërhyrje legjislative për përmirësimin e procedurave legjislative, kemi vërejt se flitet për centralizim të bizneseve dhe është koha e fundit ku duhet të kemi politika më të mira në këtë drejtim, nuk e di se a ka në ndonjë vend të botës qytetari tonë me ia sjellë orët digjitale pa ia lënë mundësin qytetari në treg me zgjedh cilën është -dashtë, pastaj arkat

fiskale nuk kanë nevojë me u centralizua. Ne jemi për treg të hapur dhe së bashku duhet të krijojmë mundësin të ndryshojmë edhe politikat burokratike dhe ato që kanë sjellë deri të centralizimi i ndërmarrjeve dhe bizneseve.

Luljeta Gutaj -Veseli - Pajtohet me vërejtjet e dhëna nga parafolësit për raportin.

Në vazhdim pyeti zv. ministrin se a ka informacion se a ka pasur prioritet ndonjë marrëveshje me shtetet e ndryshme, apo cilat janë prioritetet tuaja që të keni marrëveshje për mbështetje të bizneseve kosovare nga vendet e Evropiane apo më gjerë.

Sa i përket trajnimeve të stafit, pyeti se në cilat fusha do të mbahen trajnimet dhe kush do t'i mban trajnimet, do të jenë ekspertet vendorë apo do t'i merrni nga jashtë.

Në pyetjen e fundit pyeti e cila tha ka të bëjë më tepër me ministrin e infrastrukturës, por pyeti se a është në dijeni zv. ministri për një marrëveshje në mesin e disa marrëveshjeve të cilat janë lidhur mes Kosovës dhe Italisë, bëhet fjalë për marrëveshjen për transportin rrugor që është ratifikuar nga Presidentja e Kosovës, në korrik të vitit 2014 dhe në parlamentin e Italisë ishte një ndryshim se duhet të votohet në parlament, kurse marrëveshja ende është në Ministrinë e Financave të Italisë dhe ende nuk ka shkuar në Parlament dhe bizneset kosovare çdo ditë marrin dënime mjaft të larta për autobus, autobusët janë të bllokuar dhe bizneset kosovare po bllokohen nga një neglizhencë për ta bartur marrëveshjen në parlament për ta votuar.

Andaj a jeni në dijeni lidhur me këtë dhe a mund të merrmi ndonjë iniciativë që kjo marrëveshje të shkojë sa më shpejt në parlamentin Italian.

Zv. ministri - Tha se nuk ishte në dijeni për marrëveshjen me Italinë për transportin rrugor, por me Shqipërinë problem janë topografët, kemi probleme me mahunet që dalin në Shqipëri, sepse nuk jemi anëtarë të një organizate evropiane, kurse Shqipëria me vendim të kryeministrit, të gjitha makinat që lëvizin në Shqipëri duhet me e pasur atë certifikatë. Ne e kemi kontaktua për me zgjidhur problemin.

Kryetarja i tha zv. ministrit se këtë takim nuk e konsideron të përmbyllur dhe presim të vini me përgjigje për pyetjet të cilat u parashtruan, presim ta kemi një raport me të vërtetë serioz i cili i adreson qasjet kah integrimet evropiane në fushën e tregtisë dhe industrisë dhe në fushat të cilat i mbulon se pjesa më e madhe e MSA ka të bëjë me biznes dhe ekonomi dhe besoj që do të na vini me një raport të mirëfilltë me kohë dhe të vini me përgjigje.

Zv.ministri u zotua se me kohë do ta dërgojnë raportin dhe tha se do të tentojmë me e përmirësuar dhe kërkoj nga Komision që me kohë ta dërgonin njoftimin.

Të ndryshme

Kryetarja lidhur me këtë pikë paraqiti disa propozime:

1. Ajo tha se edhe më herët, disa herë kemi biseduar se do ta organizojmë një konferencë rajonale me mbështetje të GIZ-it, si partner që këtij Komisioni i ka ndihmuar edhe mandatin e kaluar, së bashku kemi bërë një draft agjendë të cilën e keni përpara.

2. Pasi dita e Evropës është afër dhe pasi kemi mbështetje në rregulloren e punës atëherë të diskutojmë dhe të ja bëjmë një kërkesë Kryesisë dhe ta bëjmë ose pikë debati ose të kërkojmë raportim duke u bazuar në nenin 74 të Rregullores së punës së Kuvendit.

3. Në vazhdim njoftoj lidhur me disa vizita të planifikuara:

Nga Turqia e kam pranuar kopjen e ftesës nga Komisioni për Integritet Evropiane i Turqisë të cilët na ftojnë për vizitë në vjeshtë.

Me grupin e miqësisë të Francës, kur ishte në Kosovë, kemi biseduar për një prej pikave të rëndësishme që është ligji për përgjime i cili kishte kaluar te ata dhe pritje të shpejti të vije edhe te ne në Parlament, ku do t'i shkëmbejmë përvojat, jemi në pritje të ftesës për me realizuar vizitën. Po ashtu me Holandën kemi pas një shkëmbim të emailave dhe ata kanë shpreh

interesim për ftesën, ose ne të shkojmë në Holandë ose ata të vijnë në Kosovë për bashkëpunim të dy komisioneve!

Në senatin Italian dhe në dhomën e deputetëve ishim një delegacion prej tre anëtarëve bashkë me ministrin e integriteteve dhe aty iu kam bërë ftesën, një ftesë gojore dhe së shpejti do ta dërgojmë ftesën zyrtare për ta vizituar Kosovën.

Me projektin e Binjakëzimit presim në shtator të nënshkruhet marrëveshja dhe do bëhet vendosja zyrtare e bashkëpunimit me Kuvendin, ku si fokus kryesor do ta ketë Komisionin për Integritet Evropiane. Me këtë projekt është planifikuar edhe një vizitë në Kroaci për t'i shkëmbyer përvojat si shtet i fundit që ka hyrë në BE.

Arben Gashi - Tha që delegacionet që përfaqësojnë Kuvendin të jenë me rotacion, sepse dikush të shkojë gjithmonë e dikush asnjëherë, sepse do të krijohet një raport më i mirë bashkëpunimi dhe mundemi me i shpërnda resurset tona dhe sipas rregullores së punës së Kuvendit pas kthimit nga vizita duhet raportuar në Komision dhe Kuvend.

Kryetarja - Tha se pa tjetër që do të shkojmë me rotacion deri më tani nuk kemi pasur shumë vizita, por nga ajo që ju njoftova për vizita do të kemi rast që të bisedojmë dhe organizohemi me kohë.

Rrustem Mustafa - Kërkoj që çdo ftesë dhe çdo shkresë që ka të bëjë me vizita të na njoftojë administrata me kohë, sepse për takimet që na njoftuat sot do të kishte qenë mirë të ishim njoftuar më parë, sepse folët për komunikime të rëndësishme.

Kryetarja- Tha se zyrtarisht vetëm për Turqi e kam pranuar ftesën, kurse këto të tjerat janë tentative dhe çka do të vjen do të ju përcjellim me kohë.

Ilir Deda - I njoftoi që me Komisionin për çështje evropiane të senatit italian jemi marrë vesh të kemi konsultime të rregullta vjetore. Këtë praktikë kishin me filluar me Serbinë dhe është mirë që Komisioni ynë për Integritet Evropiane në tërësi me Komisionin për çështje Evropiane i Senatit të Italisë në tërësi të kemi konsultime vjetore për agjendën evropiane.

Ai po ashtu kërkoj që të ulemi ta hartojmë një udhëzues për raportim me shkrim të ministrave dhe të ju dërgojmë nëpër ministri, sepse nuk janë të standardizuara me të tjerët, deri më tani kemi pa se forma e raportimit të ministrave ka qenë e mangët.

Kryetarja tha do ta caktojme një pikë të rendit të ditës ku do të diskutojmë lidhur me mbarrëvajtjen e punëve të komisionit.

Lidhur me konferencën kryetarja kërkoi të diskutojnë për organizimin e një konferencë rajonale që do të mbahet me dt. 2 qershor, në të cilën do të ftohen kryetarët e komisioneve nga shtetet që marrin pjesë në COSAP, kurse Kroacinë do ta ftojme në cilësinë e ekspertit dhe do të organizohet në tri panele paralele, paneli për sundimin e ligjit, paneli për zhvillimin ekonomik dhe paneli për bashkëpunimin rajonal.

Nëpër secilin panel duhet të marrin pjesë nga 3 anëtarë në mënyrë që i tërë Komisioni të përfshihet nëpër panele dhe në secilin duhet të caktohet nga një moderator dhe në fund të paneleve duhet të nxjerrën konkluzionet që do të dalin si rekomandime të konferencës. Në konferencë do të marrin pjesë edhe ministri i Integriteteve, z. Samuel Zhubogari, disa kryetarë të Komisioneve të Kuvendit edhe disa përfaqësues nga shoqëria civile, ku u propozua të marrin pjesë Venera Hajrullahu nga KCSF, Fisnik Korenica nga Grupi për studime juridike dhe politike, Dastid Pallaska etj.

Gjatë kësaj mbledhje nuk u vendos se kush do të marrë pjesë nëpër panele, por në mbledhjen e radhës mbeti të caktohen anëtarët dhe të caktohen të gjitha detajet tjera lidhur me konferencën.

Mbledhja përfundoi në orën 12:50

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetare e Komisionit

Znj.Teuta Sahatqia